

VENDIM
Nr. 1005, datë 9.12.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “MAMINAS-GJIRI I LALËZIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Maminas-Gjiri i Lalëzit”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 6 684 254 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 684 254 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësim”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
 RRUGOR “MAMINAS-GJIRI I LALËZIT”

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i Z. Kad.	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi	Lloji i objektit	Vlera (lekë)	Shënime
1	Sefer Luku	2590	443/20	72 m ²	Ndërtesë	1 826 451	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Hasan Zenel Sallaku	3137	62/11	72 m ²	Objekt banimi	2 515 944	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Kalem Sallaku	3137	63/8		Mur rrethues	403 205	Leje ndërtimi
4	Naim Gjergji	2065	38/33	30 m ²	Ndërtesë	1 338 945	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Rustem Hoxha	3137	62/9		Mur rrethues	599 708,7	Leje ndërtimi
	SHUMA TOTALE					6,684,254	